



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 139/26 Dt. 26.03.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj njoftimit të publikuar nga Komisioni që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, sipas shpalljes publike për rregullimin e transportit linjor urban-periferik në relacionin Gërinqare-Prizren-Gërinqare, me nr. reference 05-343/14843, datë 03.02.2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
  - 1.1. Muhamet Bajrami, .....kryesues i komisionit,
  - 1.2. Agnesa Thaqi Kurejshi,.....anëtare,
  - 1.3. Laura Suka,.....anëtare.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me shpalljen publike për rregullimin e transportit linjor urban-periferik në relacionin Gërinqare-Prizren-Gërinqare, me nr. reference 05-343/14843, datë 03.02.2026, si dhe me aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Të emëruarve,
  - Arkivës së Kryetarit.

